



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0173**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi-Kryetar, Vedat Poterqoi- Anëtar, Vjosa Gradinaj-Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Avokatura Istrefi” sh.p.k., me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës -Ritender” me nr. të prokurimit: 616-21-3575-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me 13/06/2023, mori:

## **Vendim**

1. **ANULOHET** aktiviteti i prokurimit “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës “-Ritender me numër të prokurimit 616-21-3575-2-1-1 i iniciuar nga AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës
2. Lejohet të bëhet kthimi i tarifave së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 13.03.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 njoftimin mbi vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës -Ritender” me nr. të prokurimit: 616-21-3575-2-1-1.

Me datë 14.02.2023, Operatori Ekonomik “Avokatura Istrefi” sh.p.k., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datë 23.03.2023, AK, eka refuzuar, si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 13.03.2023, për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Me datën 31.03.2023, Operatori Ekonomik “Avokatura Istrefi” sh.p.k., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 173/2023, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 600.000,00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 14 mars 2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 24 prill 2023 Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ka deklaruar se nuk pajtohem me raportin e ekspertit shqyrtues.

Me datë 28 prill 2023 OE “Avokatura Istrefi” sh.p.k., me seli në Prishtinë, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 14.04.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “Avokatura Istrefi” sh.p.k., me seli në Prishtinë, të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 13.03.2023 dhe lënda të kthehet në rivlerësim (*njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit*).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

#### Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

##### Përgjigje në pretendimin ankimor 1

Aktiviteti i Prokurimit me titull: “Shërbime te veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës” nga AK Kuvendi Komunal i Prishtinës ka filluar me publikimin e Njoftimit për kontratë me datë 09.06.2021. Me datën 17.08.2021 në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së është shpërblyer me kontratë OE “Avokatura Istrefi SHPK” me çmimin më të ulët të poentuar 456.72 Euro.

I pa kënaqur me vendimi e AK-së me datë 23.08.2021 OE “Labinot Vata &Partners”, ku të njëjtit me datë 24.08.2021 i refuzohet kërkesa për rishqyrtim dhe AK vendos të vazhdoj me tutje me aktivitetin e prokurimit.

Me datë 01.09.2021 OE “Labinot Vata &Partners”, paraqet ankese ne OSHP, ku eksperti shqyrtues me datë 13.09.2021 ka publikuar raportin e ekspertizës ku ka rekomanduar që ankesa e OE “Labinot Vata &Partners”, të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim. Me që OSHP ishte pa Bord dhe për këtë lëndë nuk ka pas Vendim, andaj pas funksionalizimit të Bordit të OSHP-së me datë 12.07.2022 me Vendimin nr. 642/21 “hudhet si jasht afatit për rishqyrtim” ankesa e OE “Labinot Vata &Partners”.

AK-ja me datë 15.07.2022 ka njoftuar palët për dhënie të kontratës OE “Sejdiu & Qerkini” sh.p.k në procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në kohëzgjatje prej 6 muajve, duke mos e ftuar OE ankues “Avokatura Istrefi SHPK”, ku i njëjti paraqet ankesë në OSHP.

Me datën 19.08.2022, AK-ja publikon njoftimin mbi vendimin ku anulon aktivitetin e prokurimit.

Me datë 28.08.2022 OE “Avokatura Istrefi” sh.p.k, parashtron ankese në OSHP, ku është publikuar ekspertiza nr. 410/22, ku eksperti shqyrtues ka aprovuar pjesërisht të bazuar ankesën e OE “Avokatura Istrefi” sh.p.k.

OSHP me datën 13.12.2022 ka nxjerr vendimin e PSH nr.410/22, ku ka aprovuar ankesën e operatorit ekonomik “Avokatura Istrefi” sh.p.k.,dhe ka obliguar AK që lëndën ta kthej në rivlerësim.

Në pikën III të vendimit 410/22 i datës 13.12.2022, Paneli obligon AK që në afat prej 10 ditës ta informoj Panelin në lidhje me veprimet e ndërmarra, në të kundërtën Paneli do të ndërmarr masa ndaj AK-së.

Me datën 26.01.2023, Paneli Shqyrtues nxjerr urdhëresë me nr. 410/22, për Autoritetin Kontraktues, ku ka urdhëruar AK që në afat prej 5 ditëve të njoftoj AK dhe OE “Avokatura Istrefi” sh.p.k., lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së.

Me datë 13.03.2023, AK-ja ka publikon njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku në rezultatin e këtij aktiviteti të prokurimit AK-ja vendos të anuloj aktivitetin e prokurimit pasi të gjithë OE janë të papërgjegjshëm dhe nuk ka buxhet për realizimin e këtij aktiviteti.

Ndërsa në Letrat standarde për tenderues të eliminuar OE “Avokatura Istrefi SHPK”, si arsye të eliminimit i theksohen këto; Shih në vijim arsyen:

Me datë 17.03.2023 OE ankues “Avokatura Istrefi”sh.p.k., ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim ku me datë 23.03.2023 i refuzohet ankesa si e pa bazuar.OE ankues me datë 30.03.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP.

#### Përgjigje në Pretendimet ankimore

Eksperti Shqyrtues, sqaron se nga fillimi i këtij aktiviteti te prokurimit e deri me tani ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, ku janë publikuar dy ekspertiza, dy vendime të Panelit Shqyrtues dhe 1 Urdhëresë për zbatim të vendimit.

Në lidhje me arsyetimin e AK-së se për këtë aktivitet të prokurimit nuk ka buxhet, eksperti shqyrtues sqaron aktiviteti është paraparë të jetë për 36 muaj dhe vlera e parashikuar është 600 000.00 Euro, mirëpo arsyetim nuk është i qëndrueshëm për faktin se në planifikimin përfundimtar të prokurimit për vitin Fiskal 2023, këtë lloj të shërbimit AK e ka paraparë në numrin 19 të listuar në listë , me numër të fjalorit PP 93411300-5 në vlerë 150 000.00 Euro, dhe për vitet tjera nuk janë planifikuar mjetet.Ndërsa lidhur me arsyen tjetër të eliminimit të OE ankues në lidhje me Referencat, eksperti shqyrtues vlerëson se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve duhet të bëhet konform kërkesave të dosjes së tenderit ku në rastin konkret janë kërkuar si në vijim: *“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku dy shërbime te ngjashme, në 3 (tri ) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë)’*.

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: *“Operatori ekonomik duhet te plotësoj një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te shërbimeve”*.

Operatori Ekonomik ankues në ofertën e tij ka ofruar 3 referenca, dhe AK ka kontestuar vërtetësinë e njëres referencën, eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit të aktivitetit te prokurimit AK të bëjë vërtetimin e referencave të ofruara nga OE ankues, të cilat i ka përmendur në përgjigjen e kërkesës për Rishqyrtim dhe të konstatoj që dy referencat tjera a e

plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit.

Eksperti Shqyrtues, konsideron se anulimi i aktivitetit të prokurimit nuk është në harmoni me dispozitat e nenit 62 të LPP-së, andaj dhe kërkon nga AK që të bëjë Rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit duke pas parasysh Nenin 59 dhe 72 të LPP-së, si dhe të bëjë Rivlerësimin e Aktivitetit të Prokurimit sipas Vendimit të P.SH nr.410/22 i dt. 12.12.2022.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

### **--Konstatimet e panelit shqyrtues--**

Paneli konstaton në vijim se, Ankesa e OE “Avokatura Istrefi”sh.p.k. është ushtruar në pajtim me paragrafin 1, të Nenin 111 të nenit sipas të cilit, çdo palë e interesuar ka të drejtë të dorëzojë një ankesë në OSHP. Kurse, pretendimet ankimore në rastin konkret, atakojnë OE te rekomanduar për dhënie të kontratës.

Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tije i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesa në këtë rast, mirëpo paneli nuk i mbështet konstatimet e ekspertit shqyrtues për rastin konkret. Në kontekstin e analizimit të gjithmbarshëm të shkresave të kësaj lënde Paneli Shqyrtues krijoi mendimin e pavarur të tij duke konstatuar se dëshmitë e ofruara nga ana e autoritetit kontraktues për rastin konkret përmban një shpjegim profesional.

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha provat në shkresat e kësaj lënde, përfshirë njoftimin për kontratë, procesverbalin e hapjes së ofertave, raportin e vlerësimit të ofertave, njoftimin për dhënie të kontratës, ankesën e OE, raportin e ekspertit të prokurimit dhe parashtrësat tjera me ç’rast konstatohet se, KK Prishtinë në cilësinë e AK, ka aplikuar për këtë aktivitet të prokurimit procedurë të hapur, në harmoni me nenin 32.1 të LPP, duke e përkufizuar llojin e kontratës shërbim, vlera e parashkuar e kontratës: 600.000,00 €.lidhur me këtë aktivitet te prokurimit OSHP respektivisht Paneli shqyrtues ka ndërmarr edhe vendime tjera PSh nr. 410/2023. Lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, konstatohet se mes tjerash, janë ndërmarrë edhe veprimet e cituara si më sipër nga AK dhe Palët (OE), të cilat janë prezantuar si në hyrje të arsyetimit (*Faktet dhe rrethanat procedurale*).

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe veprimet e ndërmarra nga palët (OE dhe AK), Paneli Shqyrtues ka konstatuar se:

Paneli shqyrtues mori për baze arsyetimin e dhëna nga AK për anulimet aktivitet të prokurimit në fjalë nga i cili AK është detyruar që të anuloj ketë aktivitet të prokurimit sepse aktiviteti si i tillë është shpallur në vitin 2021 me qëllim të lidhjes së kontratës për tri (3) vite në vlerën e përgjithshme 600 000 Euro ku është planifikuar që buxheti të ndahet gjatë tri (3) viteve buxhetore përkatësisht 2021-2023. Megjithatë kjo procedurë e prokurimit ka zgjatur më shumë se dy (2) vite dhe nuk ka përfunduar me sukses as në vitin 2023. Rrjedhimisht buxheti që ka qenë i planifikuar për vitet 2021 dhe 2022 tanimë është shpenzuar nga ana e AK.

Paneli shqyrtues konstaton se bazuar në tabelën e buxhetit për vitin 2023, pozicioni buxhetor I.2.2. kolona nr. 5 “Shërbimet e përfaqësimit dhe të Avokaturës” të dërguar nga AK vërehet se AK ka të planifikuar për vitin 2023 buxhetin në vlerë prej 150.000.00€, ndërsa për vitet tjera nuk janë paraparë mjete shtesë, në konotacion të këtij fakti anulimi i aktivitetit të prokurimit nga AK është në harmoni me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të Rregullores 001/2022 për Prokurimit Publik nga se dëshmitë tregojnë se AK e ka të pamundur sigurimin e mjeteve për dy vite tjera marr për baze faktin se ky është projekt tre vjeçar.

Paneli shqyrtues vlerëson se meqenëse AK e ka të pamundur sigurimin e mjeteve buxhetore për vitet tjera është me e drejt që aktiviteti i prokurimit në fjalë të anulohet në këtë fazë dhe mos të krijohen detyrime mes palëve, detyrime këto që vet AK jep deklarim se e kanë të pamundur që ti sigurojnë për realizim të projektit në fjalë.

Andaj AK me të drejt ka aplikuar nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin 2 të LPP ku kjo dispozite përcakton se “Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës nëse të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit”.

Paneli shqyrtues konstatimin e lartcekur e mbështet në faktin se nuk është kontestues fakti se për këtë procedurë të prokurimit ekzistojnë vetëm 150 000 Euro dhe nuk ekziston buxheti i planifikuar prej 600 000 Euro për këtë aktivitet të prokurimit. Fakt i cili është evident edhe në tabelën e buxhetit për vitin 2023 sipas linkut si më poshtë:

[https://prishtinaonline.com/uploads/1\\_propozim\\_buxheti\\_2023.pdf](https://prishtinaonline.com/uploads/1_propozim_buxheti_2023.pdf)).

Paneli shqyrtues i kundërshton konstatimin e ekspertit shqyrtues lidhur me atë se “Operatori Ekonomik ankues në ofertën e tij ka ofruar 3 referenca, dhe AK ka kontestuar vërtetësinë e njërës referencën, ku eksperti rekomandon që gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit AK të bëjë vërtetimin e referencave të ofruara nga OE ankues, të cilat i ka përmendur në përgjigjen e kërkesës për Rishqyrtim dhe të konstatoj që dy referencat tjera a e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit”.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit, ( kryesisht në përgjigjen e datës 28.04.2023 të dërguar nga AK) vlerëson se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimi, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka vepruar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së, dhe anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjale është në harmoni me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të Rregullores 001/2022 për Prokurimit Publik, prandaj paneli erdhi në përfundimin, që vendimi i AK-së -B58 Njoftimit mbi vendimin e AK, i datës 13.03.2023, mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës -Ri tender” me nr. të prokurimit: "616-21-3575-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës të mbetet në fuqi nga se i njëjti vendim është marrë në pajtim me dispozitat e cekura si më lart, dispozita këto që lejojnë anulimin e një aktiviteti të prokurimit në këtë fazë

Vendimi sikurse në dispozitivin pika 3 të këtij vendimi u dha në kuptim të nenit 118 të LPP-se dhe nenin 31 i Rregullores së punës së OSHP-se.

*- Përfundim –*

Duke u bazuar në kompetencat e OSHP të rregulluara sipas nenit 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër. Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur.

Paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Kimete Gashi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - "Avokatura Istrefi" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: